



**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°34/2022

Hagë, 22/09/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Më 21 shtator, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi çështjen gjyqësore kundër Pjetër Shalës Trupit Gjykues. Pas njoftimit të tij më 15 shtator, Kryetarja DHSK-së Trendafilova ia caktoi çështjen Trupit Gjykues I, që përbëhet nga gjykatësit Roland Dekers, Mapi Feld-Folia, Zhilber Biti dhe Vladimir Mikula, si gjykatës rezervë.

Po më 21 shtator, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Shala pasi konstatoi se ekziston ende rrezik i moderuar që z. Shala të arratiset si dhe që i akuzuari mund të pengojë procesin ose të kryejë krime të tjera.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 19 shtator, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin e tretë për pjesëmarrjen e viktimave dhe pranoi gjashtë parashtrues të rinj si viktima pjesëmarrëse në proces. Ata do të përfshihen në grupin ekzistues me dy viktima pjesëmarrëse dhe do të përfaqësohen nga i njëjti mbrojtës viktimash.

Më 20 shtator, Trupi Gjykues I urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Salih Mustafa. Trupi Gjykues konstatoi se ekziston ende rreziku që i akuzuari të pengojë procesin me anë të ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre. Trupi Gjykues më tej konstatoi se nuk ka masa më të buta se paraburgimi në objektin e paraburgimit të DHSK-së, të cilat mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet.

Më 16 shtator, për arsye humanitare bindëse, Paneli i Apelit udhëzoi Zyrën Administrative të organizojë një vizitë në Kosovë të z. Gucati si i paraburgosur, për t'u





**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°34/2022

Hagë, 22/09/2022

takuar me familjen e ngushtë. Z. Gucati qëndroi si i paraburgosur dhe nën kujdesin e Dhomave të Specializuara gjatë gjithë vizitës së tij. EULEX-i dhe Policia e Kosovës i ofruan mbështetje Dhomave të Specializuara të Kosovës gjatë kësaj vizite.

Më 26 gusht, në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesat e paraqitura nga Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Krasniqit lidhur me pretendimin për mosrespektim të detyrimeve për nxjerrjen e materialeve të rregullës 103 të Rregullores nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Sidoqoftë, Gjykatësi Giju nxiti ZPS-në të përmbushë plotësisht detyrimet e saj lidhur me nxjerrjen e materialeve shfajësuese dhe t'i japë përparësi nxjerrjes së këtyre materialeve mbi afatet paralele apo detyrimet për materiale të tjera. Gjithashtu, ZPS-ja u urdhërua që brenda 7 tetorit të dorëzojë një raport lidhur me nxjerrjen e materialeve, ku të shpjegojë vështirësitë e hasura gjatë përmbushjes së detyrimeve për nxjerrjen e materialeve të rregullës 103.

Versioni i redaktuar publik i këtij vendimi doli më 13 shtator dhe mund të gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Më 15 shtator, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi apelin e Mbrojtjes së Veselit që kundërshtonte vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të 25 majit, me të cilin pranoi 12 viktimat si pjesëmarrëse në proces dhe miratoi kërkesën për mosnxjerrjen e identitetit të tyre.

Në këtë vendim, Paneli i Apelit konstatoi se ruajtja e anonimitetit të viktimave në këtë fazë të procedurave nuk shkel të drejtat themelore kushtetuese dhe ndërkombëtare të të akuzuarit, dhe pajtohet me konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se, në këtë fazë, masat mbrojtëse kanë ndikim minimal në aftësinë e Mbrojtjes për t'u përgatitur për dëshmitë e ardhshme të dëshmitarëve.





**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°34/2022

Hagë, 22/09/2022

Paneli më tej rikujtoi se ruajtja e anonimitetit të viktimave pjesëmarrësve parashihet shprehimisht në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara dhe se mund të justifikohet në rrethana të jashtëzakonshme.

Ndër lajme të tjera: Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës, Gjykatëse Ekaterina Trendafilova, këtë javë ndodhet në një vizitë në Kosovë. Gjatë vizitës, ajo mbajti një aktivitet në internet në kuadër të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim me shoqërinë civile dhe median, si dhe një ligjëratë me studentët e Fakultetit të Juridikut në Prishtinë. Kryetare Trendafilova përsëriti përkushtimin e saj për të komunikuar me shoqërinë civile dhe median në Kosovë për t'u dhënë informacione rreth punës së Gjykatës si dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje.

